

**RREGULLORE MBI PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TË DREJTËS SË  
PËRJASHTIMIT PËR INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT NATYROR**

**KAPITULLI I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**(Qëllimi dhe objekti)**

- (1) Qëllimi i Rregullores mbi procedurat për dhënie e të drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror, (më poshtë – “Rregullorja”) është të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jo – diskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e Paketës së Tretë të Energjisë, që përfshin rolin e Entit Rregullator të Energjisë (këtu dhe më poshtë – “ERE”).
- (2) Objekti i kësaj Rregulloreje është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re ndërkohë që siguron funksionimin si duhet të tregut të Gazit Natyror.

**Neni 2**

**(Fusha e Veprimit)**

- (1) Kjo Rregullore aplikohet për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re më poshtë: interkoniektorët midis Shqipërisë dhe Palët e tjera të Komunitetit të Energjisë, Gazit Natyror të Lëngshëm dhe hapësirat e depozitimit të përshkruara në nenin 3 më poshtë.
- (2) Rregullorja përcakton kërkesat e procedurave për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re, përfshirë termat dhe kushtet për paraqitjen e dokumentave, të dhënave dhe informacioneve në ERE.
- (3) Në këtë Rregullore të gjitha termat janë përdorur sipas kuptimit të përshkruar në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar (këtu dhe më poshtë: “Legjislacioni”) dhe do të aplikohet në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurat e brendshme dhe organizimin e ERE në konsultim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (këtu dhe më poshtë “Sekretariati”).

## **KAPITULLI II**

### **Aplikimi për Përrjashtimin**

#### **Neni 3**

#### **(Aplikimi për Përrjashtimin)**

(1) Infrastruktura kryesore e re e gazit, siç është interkoniektori midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Komunitetit të Energjisë, LNG dhe hapësirat e depozitimit, mundet që sipas kërkesës të përjashtohen nga ERE nga dispozitat e pikës 1, të nenit 16, pikës 5, të nenit 33, gërmat “dh” dhe “e”, të pikës 1, të neni 17 dhe nenet 36, 42, 63, 64 dhe 71, të Legjislacionit, sipas kushteve të mëposhtme:

- a. investimi duhet të rrisë konkurrencën në furnizimin me gaz natyror dhe të forcojë sigurinë e furnizimit;
- b. niveli i rrezikut i bashkangjitur investimit është i tillë që investimi të mos bëhet nëse nuk është dhënë përjashtimi;
- c. infrastruktura duhet të jetë në pronësi të një personi i cili është i ndarë të paktën për sa i përket formës së tij ligjore nga operatorët e sistemit në sistemet e të cilëve do të ndërtohet infrastruktura;
- d. tarifat u vendosen përdoruesve të asaj infrastrukture;
- e. përjashtimi nuk e dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, ose funksionimin eficient të sistemit të rregulluar me të cilin është i lidhur infrastruktura.

(2) Pika (1) e këtij neni zbatohet gjithashtu për rritjen e konsiderueshme të kapacitetit në infrastrukturën ekzistuese dhe për modifikimet e infrastrukturave të tilla që mundësojnë zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit me gaz natyror.

(3) ERE, sipas rastit mund të vendosë mbi përjashtimin referuar pikave (1) dhe (2) të këtij neni sipas kriterëve të vendosura në këtë nen.

## **KAPITULLI III**

### **PARAQITJA E DOKUMENTAVE, TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT**

#### **Neni 4**

#### **(Lista e dokumentave, të dhënave dhe informacionit)**

(1) Aplikuesi, së bashku me aplikimin me shkrim për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re, duhet të paraqesë në ERE dokumentat e mëposhtëm për të arsyetuar kërkesën për përjashtimin. Ky informacion duhet të përfshijë, por nuk duhet të kufizohet tek:

- a) Paraqitja e përshkrimit të infrastrukturës kryesore të re për të cilën është dhënë përjashtimi;
- b) Dispozitat nga Legjislacioni nga të cilat kërkohet përjashtimi;
- c) Relacionin për pjesën e përjashtuar të infrastrukturës kryesore të re;
- d) Kohëzgjatjen e përjashtimit të kërkuar për çdo dispozitë nga gërma “b”, e pikës (1), të këtij neni;
- e) Analiza teknike-ekonomike e projektit:
  - i. studimi i fizibilitetit për infrastrukturën kryesore të re,
  - ii. rezultatet e testimit të tregut që vërtetojnë interesin e tregut në përputhje me nenin 78, pika 11, të Legjislacionit,
  - iii. analiza e kriterëve të përjashtimit bazuar në të dhënat e projektit të infrastrukturës dhe testimit të tregut;
- f) paraqitja e një propozimi për çmimin për përdorimin e infrastrukturës dhe evolucionin e tij gjatë kohëzgjatjes së përjashtimit, në rast se kërkohet përjashtim nga aksesin i rregulluar i palëve të treta (TPA).
- g) të dhënat dhe informacioni për aplikuesin siç parashikuar në nenin 5, të kësaj Rregulloreje.

(2) Të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacioni që kërkohet sipas këtij neni duhet të paraqitet në ERE në shqip dhe në gjuhën Angleze me shkrim dhe në mënyrë elektronike me email dhe /ose me cd ose usb.

## **Neni 5**

### **(Të dhënat dhe informacioni mbi aplikuesin)**

(1) Aplikuesi duhet të paraqesë në ERE të dhënat dhe informacionin më poshtë:

- a) Kopje të noterizuara të dokumentave mbi përfshirjen dhe regjistrimin;
- b) Listën për licencat, lejet dhe/ose autorizimet e marra nga aplikuesi për veprimtaritë në sektorin e gazit natyror, të dhëna nga autoritetet e vendeve të tjera dhe kopje të noterizuara të këtyre licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve;

- c) Listën e aksionerëve përfshirë informacionin në lidhje me aksionet dhe të drejtat e aksionerëve;
- d) Listën e shoqërive tregtare, të cilat janë në kontroll të drejtpërdrejtë ose jo nga shoqëria që po aplikon, po ashtu duke shpjeguar qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat përkatëse të aplikuesit;
- e) Listën e shoqërive tregtare, të cilat kanë kontroll direkt ose jo tek aplikanti dhe shpjegojnë qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat respektive të këtyre shoqërive;
- f) Listën e shoqërive të tjera tregtare që kanë lidhje (që do të thotë grupe shoqërisht që kanë lidhje), të cilat tregojnë mënyrën e marrëveshjeve të veçanta me aplikuesin;

(2) Nëse më shumë se një shoqëri po aplikon për përjashtimin, të gjitha shoqëritë do të konsiderohen si aplikues për të dhënat dhe informacionin dhe secila prej tyre duhet ta paraqesë atë në ERE.

(3) Në çdo kohë gjatë periudhës së përjashtimit ERE, dhe sipas rastit Sekretariati, mund të kërkojnë aplikuesit dokumenta shtesë, të dhëna dhe/ose informacion përkatës për përjashtimin.

(4) Aplikuesi duhet të njoftojë ERE për çdo ndryshim tek dokumentat e paraqitur, tek të dhënat dhe/ose informacioni menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se (5) pesë ditë pune, pasi ka ndodhur ndryshimi dhe duhet të paraqesë dokumentat, të dhënat dhe/ose informacionin e ndryshuar.

(5) Të gjitha dokumentat duhet të jenë kopje origjinale dhe/ose kopje të noterizuara.

(6) Aplikanti duhet të sigurojë përjashtimet për kërkesat e vendosura në nenin 4, dhe tek ky nen i cili në kohën e aplikimit nuk ka përfunduar.

(7) Para se të vendoset për përjashtimin, ERE në çdo kohë mund të kërkojë informacion shtesë nga aplikuesi.

## **KAPITULLI IV**

### **PROÇEDURA E PËRJASHTIMIT**

#### **Neni 6**

#### **(Proçedurat që aplikohen dhe përjashtimi)**

(1) ERE duhet të vendosë mbi përjashtimin bazuar në nenin 78 të Legjislacionit dhe proçedurave të caktuara në këtë Rregullore.

(2) Në rastin kur infrastruktura në fjalë është me vendndodhje në një ose më shumë Palë të Komunitetit të Energjisë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë duhet të paraqesë një opinion këshillues për ERE dhe autoritetin rregullator të një shteti tjetër anëtar të BE ose palën kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të përfshirë, që mund të përdoret si bazë për vendimin e tyre mbi përjashtimin, brenda 2 (dy) muajve nga data kur kërkesa për përjashtimin është bërë nga autoritetet rregullatore.

(3) Në rastin kur autoritetet rregullatore të përfshira bien dakord mbi kërkesën për përjashtimin brenda 6 (gjashtë) muaj nga data kur është marrë nga autoriteti rregullator i fundit, ata duhet të informojnë në varësi të situatës, Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë mbi vendimin e tyre.

(4) Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë duhet të ushtrojë të gjitha detyrat që u janë ngarkuar autoriteteve rregullatore të shteteve anëtare të BE dhe Palëve Kontraktore të Komunitetit të Energjisë të përfshira tek ky nen:

a) në rastin kur të gjitha autoritetet rregullatore të përfshira nuk kanë qënë në gjendje të arrijnë në një marrëveshje brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muaj nga data kur kërkesa për përjashtimin është marrë nga autoriteti rregullator i fundit;

b) sipas një kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullatore të përfshira.

(5) Të gjithë autoritetet rregullatore të përfshira mund të kërkojnë së bashku që periodha referuar gërmës “a”, pika (6) i këtij neni duhet të zgjatet deri në 3 (tre) muaj.

(6) Pavarësisht pikës (3), të nenit 3 të Rregullores, ERE mund të aplikojë tek Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë për të paraqitur opinionin e tij mbi kërkesën për përjashtimin, me qëllim të vendimit zyrtar. Ky opinion do të publikohet së bashku me vendimin.

(7) ERE duhet t'i paraqesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe në varësi të situatës Komisionit të BE, në rastin kur një shtet anëtar është i përfshirë, në kohë, një kopje të çdo kërkesë për përjashtimin ashtu si është marrë kërkesa. Vendimi do t'i njoftohet në kohë nga ERE Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së bashku me informacionin përkatës në lidhje me vendimin. Ky informacion duhet t'i paraqitet Sekretariatit i plotë që Sekretariati të marrë një vendim të bazuar.

(8) Brenda dy (2) muajve pas datës kur është marrë njoftimi, referuar pikës (2) të këtij neni, Sekretariati do të shpërndajë Opinionin në ERE dhe do ta ftojë këtë të fundit të ndryshojë ose të tërheqë vendimin për dhënien e përjashtimit. Kjo periudhë dy mujore mund të zgjatet me një periudhë shtesë prej dy muaj në rastin kur kërkohet informacion tjetër nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Kjo periudhë shtesë fillon ditën pas marrjes së informacionit të plotë. Periudha fillestare prej dy muajsh mund të zgjatet me miratim të Sekretariatit të Komunitetit të

Energjisë dhe të ERE. Në mungesë të një opinionit nga Sekretariati, brenda periudhës së caktuar tek ky dokument, mendohet se Sekretariati nuk ka kundërshtime në lidhje me vendimin e ERE.

(9) Kur informacioni i kërkuar, siç përcaktohet në pikën (3) të këtij neni, nuk është dhënë brenda periudhës së përcaktuar në kërkesë do të konsiderohet se njoftimi i dërguar në përputhje me pikën (2) të këtij neni, do të tërhiqet me përjashtim të rastit kur ERE, para periudhës së përfundimit të afatit të përmendur në pikën (3) përmes një deklaratë të arsyetuar, ka njoftuar Sekretariatit që e konsideron njoftimin të plotë, ose periudha është zgjatuar me miratimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe ERE.

(10) Brenda dy (2) muajve nga dita e marrjes së opinionit të Sekretariatit, ERE do të marrë vendimin përfundimtar lidhur me përjashtimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit, duke ju referuar në maksimum këtij opinionit. Vendimi i ERE dhe opinionit i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë do të publikohen së bashku.

(11) Në rastin kur vendimi përfundimtar i ERE ndryshon nga opinionit i Sekretariatit, ERE do të sigurojë dhe publikojë së bashku me këtë vendim relacionin në lidhje me vendimin e ndryshuar dhe duhet të informojë Sekretariatit.

(12) Vendimi përfundimtar i ERE mbi përjashtimin do të publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ERE.

## **Neni 7** **(Vendimi mbi përjashtimin)**

(1) ERE do të miratojë një projekt vendim mbi përjashtimin brenda 60 ditëve pas aplikimit. Para marrjes së vendimit, ERE do të konsultohet me autoritetet rregullatore përkatëse dhe aplikuesit.

(2) Përjashtimi mund të përfshijë të gjitha ose pjesë të, përkatësisht infrastrukturës së re, ose të infrastrukturës ekzistuese me kapacitet të shtuar në mënyrë të konsiderueshme ose modifikim të infrastrukturës ekzistuese.

(3) Kur vendoset për dhënien e përjashtimit, do të merret në konsideratë, rast pas rasti, nevoja për të vendosur kushte në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jodiskriminues në interkonektor. Kur vendoset në lidhje me kushtet në këtë pikë duhet të merren parasysh, veçanërisht, kohëzgjatja e kontratave, kapaciteti shtesë që do të ndërtohet ose modifikimi i kapacitetit ekzistues, periudha kohore e projektit dhe rrethanat në vend.

(4) Kur jepet përjashtimi, ERE vendos për rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit. Rregullat kërkojnë që të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës të jenë të ftuar të tregojnë interesin e tyre për kapacitetin kontraktues përpara se të bëhet ndarja/alokimi i kapaciteteve në infrastrukturën e re, përfshirë ato për përdorim vetjak. ERE do të

kërkojë që rregullat e menaxhimit të kongjestioneve të përfshijnë detyrimin për të ofruar një kapacitet të papërdorur në treg dhe do t'u kërkojë përdoruesve të infrastrukturës të kenë të drejtë të tregtojnë kapacitetet e tyre të kontraktuara në tregun sekondar. Në vlerësimin e kriterëve të përmendura në germat “a”, “b” dhe “d” të pikës (5) të këtij neni, ERE do të marrë në konsideratë rezultatet e kësaj procedure të alokimit të kapaciteteve.

(5) Projekt vendimi i përjashtimit, përfshirë kushtet e përmendura në pikën (4) të këtij neni, do të arsyetohet dhe publikohet në Fletoren Zyrtare. Pa zbuluar informacionin e ndjeshëm tregtar, vendimi duhet të përmbajë:

- a) një arsyetim të detajuar mbi bazën e të cilit ERE dha ose refuzoi përjashtimin së bashku me një referencë në pikën (1) të këtij neni, duke përfshirë edhe dispozitat përkatëse mbi të cilat bazohet një vendim i tillë, përfshirë informacionin financiar që arsyeton nevojën e përjashtimit;
- b) analizën e bërë për efekt konkurrence dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit si rezultat i përjashtimit;
- c) arsyet për periudhën kohore dhe pjesa e kapacitetit total të infrastrukturës në fjalë të gazit për të cilën është dhënë përjashtimi
- ç) në rast se përjashtimi ka të bëjë me një interkonektor, rezultati i konsultimit me vendet ose autoritetet rregullatore të përfshira;
- d) kontributi i infrastrukturës në lidhje me shumellojshmerine e furnizimit me gaz natyror.

## **KAPITULLI V**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 8**

#### **(Mbrojtja e informacionit konfidencial)**

(1) Në rastet kur dokumentat, të dhënat dhe/ose informacionet, të paraqitura nga kërkuesi tek ERE ose tek Sekretariati, përmbajnë informacion konfidencial ose ndryshe informacion të ndjeshëm tregtar, aplikuesi duhet të tregojë qartë se cilat pjesë të dokumenteve, të dhënave dhe / ose informacionit do të konsiderohen si konfidenciale ose informacion i ndjeshëm tregëtar dhe të mos u zbulohen palëve të treta.

(2) ERE ose Sekretariati duhet të mbrojnë informacionet konfidenciale ose informacionin e ndjeshëm tregëtar, nëse kërkohet nga aplikuesi dhe nuk do të ketë një detyrim të tillë nëse aplikuesi nuk e ka bërë kërkesën sipas pikës (1) të këtij neni.

**Neni 9**  
**(Detyrimi)**

Personat, të cilët kryejnë shkelje të kësaj Rregullore ose vendimeve përkatëse të miratuara nga ERE, do të jenë përgjegjës sipas Legjislacionit.

**Neni 10**  
**(Zgjidhja e mosmarrëveshjeve)**

(1) Vendimi i ERE-s sipas kësaj Rregullore mund të apelohej në gjykatën kompetente (Gjykata e Tiranës / Gjykata Administrative).

(2) Pa ndikuar në pikën (1) të këtij Neni, çdo mosmarrëveshje sipas kësaj Rregullore mund të trajtohet në mënyrë miqësore përmes pajtimit dhe negociatave midis palëve. Nëse nuk gjendet një zgjidhje brenda 30 ditëve, palët në mosmarrëveshje mund të aplikojnë për asistencë pranë Qendrës së Komunitetit të Energjisë për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe Negociatave.

**Neni 11**  
**(Amendamente të rregullores)**

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, në përputhje me Rregullat për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE.

**Neni 12**  
**(Dispozitat finale)**

(1) Kjo Rregullore i nënshtrohet rishikimit dhe ndryshimit nga Bordi i ERE, në përputhje me Rregulloren për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s.

(2) Kjo Rregullore, do të botohet në faqen e internetit të ERE-s, pas miratimit dhe publikimit në Fletoren Zyrtare.

(3) Interpretimi i kësaj Rregulloreje do të sigurohet dhe bëhet publike nga ERE në përputhje me rregullat procedurale.

(4) Këto Rregulla hyjnë në fuqi datën kur ato miratohen nga ERE.